

PROCESVERBAL – Tipi i kontrates - Sherbime

PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës prokurimit: *“Shërbim e mirembajtje, program fiskalizimi, kontabiliteti , faturimi ,arketimi, magazinim e inventarizim, etje” ,per nevojat Shoqërise Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a*

**KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV):
Sherbimet e lidhura me softwaret - 72260000-5.**

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te V.K.M. nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per procedurën e sipercituar, me permbajtjen si me poshte;

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Formularin e ofertes , sipas shtojces 1
- b. Listen e cmimeve te sherbimeve , sipas shtojces 2
- c. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 9
- d. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me nenin 82 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-se nr.285, date 19.5.2021, “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik: citojme neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet te kerkoje paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit, me perjashtim te procedurave te prokurimit me vlere te vogel”, neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

2.1 Kapacitetin profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kriterëve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit, (Shtojca 9)

Ofertuesi duhet te deklaroje se permbush kriteret e pergjithshme te pranimi/kualifikimit. Keto kriteret duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 10.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a dhe 2, te LPP, nenit 41, pika 5, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", si dhe shtojces 9 te DT.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, te LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 germa b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".*

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte: " *Vlera e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operatoreve ekonomike nuk mund te tejkaloje:*

.... 40 % te vleres se parashikuar te kontrates, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar". Kjo procedure eshte nen kufirin e ulet monetar dhe per kete arsye, vlera e xhiros minimale te kerkuar, eshte brenda kufirit te parashikuar ne dispozitat ligjore te sipercituara....

Si dhe neni 55/4....." Ne kete lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet te mbajne ne konsiderate te percaktojne kriteret e thjeshtuara pranimi, me qellim nxitjen e pjesemarrjes se biznesit te vogel dhe te mesem.

Kerkesat ekonomike financiare duhet te kerkohen ne raport me objektin e prokurimit, duke marre ne konsiderate qe plotesimi i ketyre kerkesave mund te behet vetem me paraqitjen e xhiros vjetore te realizuar nga operatorët ekonomike. Vlera e xhiros se kerkuar ne kete lloj procedure prokurimi nuk mund te tejkaloje 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates, sipas parashikimeve ne nenin 43, te ketyre rregullave."

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e vertetimit te xhiros vjetore eshte bere bazuar ne nenin 43, pika 2/b, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", si dhe ne legjislacionin e fushes ne fuqi, perkatesisht ne Ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 date 29.12.2014 "Per deklarimin e detyrueshem te deklaratave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike", si dhe ne Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, date 30.01.2006, "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar. Ne çdo rast, kërkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare do te konsiderohet e permbushur nese operatorët ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Pasqyrat financiare per vitet (2021,2022, 2023) te konfirmuara nga administrata tatimore. Ne rast se operatori ekonomik eshte ne kushtet e percaktimeve te nenit 41, te ligjit nr.10091, date

05.03.2009, atehere bilancet duhet te shoqerohen edhe me raportet e auditimit ligjor te pasqyrave financiare vjetore, te kryera, nga auditues ligjore ose shoqeri audituese. Kriteri konsiderohet i permbushuar nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negative ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te fushes, konkretisht, ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme mbeshtetet ne Nenin 77, pika 3, te Ligjit Nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te fushes, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar).*

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese, kontrata te realizuara te shoqeruar me vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlere, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumatat dhe sherbimet e realizuara.
- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese: Kontrata te realizuara , fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumatat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 germa b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"Per kontratat e mallrave dhe sherbimeve vlere totale e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te vogel se 20% te vleres se perlogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten, prandaj eshte kerkuar qe sherbimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 40 % te vleres se fondit limit, qe eshte brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar.

Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme eshte vendosur brenda kufirit te vleres te percaktuar ne rregullat e prokurimit publik dhe i sherben AK per te treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kane realizuar kontrata te ngjashme me objektin qe prokurohet, ne vlere jo me te vogel se 40 % te fondit limit, ne afat, me cilesi dhe rrit besueshmerine mbi pervojen qe ka ofertuesi ne treg. Pervoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët

ekonomike duhet te paraqesin deshmi te tilla si referenca/fatura tatimore, per te provuar kryerjen e tyre qofte me sektorin privat dhe ate publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- Çertifikatë ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise”
- Çertifikatë ISO 20000 mbi “Menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit”
- Çertifikatë ISO 27001 mbi “Sistemet e menaxhimit te sigurise informatike”

Argumentim: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.

aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.

aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.

aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit:

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo certifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës, duhet të ketë të punësuar për 3 muajt e fundit të paktën 5 (pesë) punonjës, të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike, ose ekuivalent) të cilët duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

Argumentimi: Kjo kerkese vendoset ne mbështetje te nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne:

pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;

gjendjen ekonomike dhe financiare;

aftesine teknike dhe profesionale.

Per realizimin e ketij sherbimi kerkohet qe ne secilen nga fushat kryesore te projektit, operatori ekonomik te perdori personel teknik te mjaftueshem dhe te kualifikuar. Fushat e mesiperme te ekspertizes si dhe numri i personelit te certifikuar, jane kryer ne baze te komponenteve te projektit si dhe te mases se angazhimit te specialisteve. Diplomimi i punonjesve ne deget Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshine implementimin, adaptimin, testimin, migrim dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit si dhe duhet te ofroje trajnim per perdoruesit.

Te pakten 2 (dy) programues/zhvillues software te certifikuar ne nivel eksperti ne implementim ose zhvillim te sistemit te fiskalizim, te ofruar.

Argumentim: Ky kriter sherben si garanci qe OE ofertues ka te gjitha kapacitetet profesionale bazuar ne LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik. AK me vendosjen e ketij kriteri kerkon qe te kete garanci nga operatori ekonomik ofertues per njohjen e programit te faturimit dhe kjo gje garanton per implementimin, zgjidhjen e problematikave, zgjidhjen e incidenteve gjate gjithë afatit te dhe fazave te kontrates dhe gjithashtu garantoje implementimin e te gjithë specifikimeve te kerkuara nga AK. Gjithashtu keta specialiste garantojne vijueshmerine normale te punes per gjate gjithë periudhes se kontrates.

Te pakten 1 (nje) programues/zhvillues software te certifikuar ne nivel eksperti ne implementim ose zhvillim ne zgjidhjen software te fiskalizimit te ofruar.

Argumentim: Ky kriter sherben si garanci qe OE ofertues ka te gjitha kapacitetet profesionale bazuar ne LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik. AK me vendosjen e ketij kriteri kerkon qe te kete garanci nga operatori ekonomik ofertues per njohjen e programit te fiskalizimit qe do te impletoje dhe kjo gje garanton per implementimin, zgjidhjen e problematikave, zgjidhjen e incidenteve gjate gjithë afatit te dhe fazave te kontrates dhe gjithashtu garantoje implementimin e te gjithë specifikimeve te kerkuara nga AK. Gjithashtu keta specialiste garantojne vijueshmerine normale te punes per gjate gjithë periudhes se kontrates. Me disponimin e kapaciteteve profesionale te mesiperme AK merr garanci qe OE mund te beje te mundur integrimin e ketij sistemit te fiskalizimit me sistemin e faturimit brenda afateve te percaktuar ne kontrate dhe ka aftesine per te zgjidhur cdo problematike ose ngerc te lindur gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi.

Te pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar si Menaxher Projekti ne nivel profesionist Argumentim : Ky kriter garanton AK qe operatori ekonomik ka ne perberje te tij stafin me aftesi profesionale ne menyre qe i gjithë projekti te realizohet konform te gjitha kërkesave dhe afateve te percaktuara ne DST dhe specifikimet teknike. Punonjesi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerzve dhe burimeve te OE per te patur zbatim te suksesshem të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e ofrimit te sherbimeve ITIL ose ekuivalente

Argumentim: Ky kriter lidhet me rezultatet qe duhet te permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave te shprehura ne DST ku percaktohen kohet e nderhyrjeve dhe termat e tjera te nivelit te sherbimit SLA (sherbimet e mirembajtjes). Nje certifikim ITIL eshte nje set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh per realizimin e sherbimit ne teknologjine e informacionit dhe komunikimit, qe eshte pjese e qellimit te projektit te autoritetit kontraktor. Kërkesa per certifikim ITIL ose ekuivalente, i deshmon autoritetit qe operatori ekonomik, nepermjet stafit te certifikuar si me siper, garanton ideimin, konceptimin e sherbimeve IT te projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA, sipas standardeve nderkombetare te njohura, ne gjithë ciklin e tyre, perfshire ketu dhe sherbimet e mirembajtjes qe jane shume te rendesishme per AK dhe te vena ne dukje ne DST dhe specifikime teknike.

Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne nivel profesional ne sisteme me arkitekture orientuar nga sherbimet.

Argumentim: Ky kriter vjen si nevojë per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme, me institucionet financiare banke dhe jo banke te cilat kane sisteme te cilat integrohen per te rakorduar automatikisht detyrimet dhe pagesat lidhur meabonentet, me programin e fiskalizimit, integrimi keto qe perdorin protokolle standarte Soap, Rest ose ekuivalente sic eshte cituar dhe ne specifikimet teknike.

Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne nivel eksperti per njohjen ose perdorimin e sistemit te faturimit te ofruar.

Shënim: Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Argumentim: Ky kriter eshte i lidhur ngushtesisht me kërkesen specifike te parashikuar ne specifikimet teknike dhe gjithashtu e evidentuar dhe ne “Formularin e sherbimeve dhe Grafikut te Ekzekutimit” ne te cilin eshte parashikuar si ze me vete “trajnimi i perdoruesve te sistemit te faturimit”. Kjo pike ka te percaktuar mjaft qarte dhe afatet qe ka ne dispozicion OE i interesuar per te realizuar kete sherbim te kerkuar. Nisur nga cfare cituam me lart SHRUK Diber e shoh shume te nevojshme disponimin e nje punonjesi te certifikuar si njohes ose perdorues ne nivel eksperti per sistemin e faturimit qe OE do te ofroje per vete faktin qe ky eshte nje sherbim mjaft specifik dhe realizimi i tij ne kohe, afate dhe ne menyre te plote duhet te behet nga punonjes qe e njohin shume mire sistemin e faturimit te ofruar. Trajnimi i perdoruesve fundore te sistemit te faturimit objekt prokurimi duhet te realizohet sipas specifikimeve teknike dhe nga punonjesi per te cilin operatori ekonomik do te paraqese certifikaten perkatese. Ky sistem faturimi per SHRUK Diber eshte mjaft i domosdoshem qe lidhet drejtpersedrejt me arketimin e faturave ,me financat e

saj cka e ben te domosdoshem trajnimit e perdoruesve fundore ne menyre shume te sakte qe ata te mos bejne gabime qe mund te sjellin ngerc ne mbarvajtjen e punes normale te SHRUK Diber. Me disponimin e nje punonjesi te tille AK merr garanci qe OE ka ne stafin e tij punonjes me aftesi profesionale te nevojshme per realizimin e te gjitha sherbimeve te parashikuara ne kete kontrate. Trajnimi i perdoruesve eshte mjaft i rendesishem dhe jo me kot SHRUK Diber ne hartimin e kesaj DST, specifikimeve teknike dhe tabelen e sherbimeve e ka ndare ne ze te vecante dhe ka parashikuar qe OE te ofertoje cmim per kete ze.

Të paktën 1 (nje) punonjes te Çertifikuar per Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).

Argumentim: Ky kriter vërteton se operatori ekonomik ka në stafin e tij punonjës të aftë për dizejnimin, zbatimin dhe menaxhimin e sigurisë.

Një punonjës i certifikuar si CISM (Certified Information Security Manager), është i aftë për:

Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit: Gjatë implementimit të sistemi objekt kontrate, është e rëndësishme të keni një menaxher të certifikuar CISM ose ekuivalent që do të koordinojë dhe menaxhojë të gjitha aspektet e sigurisë së informacionit, marrë parasysh që në sistem do të trajtohen të dhëna sensitive dhe personale të aplikantëve.

Planifikimin e Sigurisë: Përpara implementimit të platformës, është e rëndësishme të përgatitja një plan mbi sigurinë e informacionit. Një punonjës i certifikuar në menaxhimin e sistemeve të sigurisë ofron njohuri rreth hartimit të politikave dhe strategjive të sigurisë, ndihmon në identifikimin e risqeve potenciale, dhe siguron që të gjitha aspektet e sigurisë janë të përfshira në planifikim.

Identifikimin e Rreziqeve dhe Menaxhimin: Përfshin njohuri rreth identifikimit dhe menaxhimit të risqeve të sigurisë së informacionit. Gjatë fazës së implementimit, mund të hasen sfida dhe risqe të ndryshme që kërkojnë një qasje të strukturuar për t'i adresuar.

Kontrollin e Proceve: Në fushën e sigurisë së informacionit, është e rëndësishme të sigurohen që proceset janë të sigurta.

Ruajtjen e Integritetit dhe Konfidencialitetit: Gjatë implementimit të një sistemi informatik, është e rëndësishme të sigurohet integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit..

Ligjshmëria dhe Rregullatorët: Një punonjës i certifikuar në menaxhimin e sistemeve të sigurisë ka njohuri rreth legjislacionit dhe rregullave të aplikueshme në fushën e sigurisë së informacionit. Është e rëndësishme të sigurohet që implementimi i sistemit është në përputhje me të gjitha rregullat dhe kërkesat ligjore.

Një punonjës i certifikuar CISM ose ekuivalent ka njohuri dhe përvojë në fushën e sigurisë së informacionit, ky person do të jetë në gjendje të udhëheqë dhe të sigurojë që implementimi i sistemit të jetë i sigurt dhe i përputhshëm me standardet e sigurisë së informacionit. Kjo mund të jenë kritike për ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe për përmbushjen e qëllimeve të sigurisë.

Për sa më sipër, bazuar në kompleksitetin e procedurës, është e nevojshme dhe e rëndësishme prania e një menaxheri të sigurisë së informacionit i cili të mund të hartojë dhe dizejnojë një plan të mirëdetajuar të zhvillimit të të gjithë detyrave të kërkuara duke mbajtur në konsideratë menaxhimin e incidenteve nëse do të ketë dhe menaxhimin e riskut të informacionit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 9. Perpara publikimit te njoftimit paraprak te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit OE i

kualifikuar ne vend te pare per te vertetura disponimin e punonjesve te mesiperm duhet te paraqese dokumentacionin si meposhte:

Formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se shpalljes se procedures

Certifikatat/transcriptet qe vertetojne certifikimet e mesiperme te kerkuara - Diplomat e shkolles se larte

Nje punonjes mund te disponoje me shume se nje certifikim.

Argumentimi:Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin, personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar ose partner zyrtar i cloud ku do të ofrohet shërbimi. Të vërtetohet nëpërmjet një dokumenti zyrtar të lëshuar nga ofruesi i shërbimit Cloud, i verifikueshëm, ose nëpërmjet shfaqjes në website zyrtar të ofruesit të shërbimit Cloud i emrit dhe detajeve të O.E.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme vjen se rrjedhoje ne zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, "Per Sigurine Kibernetike", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 553, date 15.07.2020, "Per miratimin e listes se infrastrukturave kritike te informacionit dhe te listes se infrastrukturave te rendesishme te informacionit", i ndryshuar.

Institucioni Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Diber eshte percaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe e rendesishme e informacionit. Per kete arsye, ne mungese te nje infrastrukture nga ana e shoqerise kerkohet qe operatori ekonomik te garantoje me ane te nje dokumenti qe eshte i certifikuar ose partner zyrtar i Cloud-it ku operon dhe mirembahet sistemi dhe back-up-et e tij per te garantuar AK per kapacitetin e provuar te OE lidhur me shfrytezimin e Cloud-it.

Te qenit i certifikuar ose partner i kompanise qe ofron sherbimin Cloud rrit garancine per AK qe OE i ploteson standardet per te qene rishites ose perdorues i sherbimit Cloud te zgjedhur per qellime komerciale dhe jo vetem per perdorim vetjak. Certifikimi ose partneriteti i cili shfaqet ne website zyrtar te ofruesve te sherbimeve cloud ose qe leshohet ne dokument zyrtar per OE te caktuar, eshte per te rritur reputacionin dhe besimin e OE te certifikuar ose me statusin partner lidhur me cilesine e sherbimeve te tij duke perdorur Cloud ne fjale, tek klientet e interesuar per sherbimet Cloud ne fjale sic edhe ne si AK jemi ne kete rast.

Sqarim:

Për sa i përket përllogaritjes së vlerës së fondit limit, ky proces është argumentuar dhe dokumentuar sipas të gjitha parashikimeve ligjore/nënligjore duke përfshirë dhe testimin e tregut.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. per ofrim zgjidhje software per fiskalizim.

Argumentimi: Argumentimi: Kerkesat e mesiperme jane percaktuar bazuar ne nenin 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, germa “a”, te VKM nr.285, date 19.05.2021, “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqiperisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni te jete ne gjuhen shqipe si dhe te kete te gjithë kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresen web te prodhuesit apo Distributorit per konfirmim te dokumentave te paraqitura. Te jete e percaktuar emri, nipt dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi te kete edhe daten e leshimit perpara dates se zhvillimit te tenderit.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave/shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave/shërbimeve sipas kërkesave ne specifikimet teknike.

Per te garantuar me sukses permbushjen e te gjithë kërkesave teknike gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates, per te garantuar zgjidhjen e problemeve te paparashikuara qe mund te hase OE gjate kryerjse se proceeve te punes deri ne dorezim te plote te kontrates, nevojitet të kenë mbështetje nga prodhuesi i zgjidhjes për rastet e perballjes me situata te paparashikuara si dhe për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë fazes se mirembajtjes.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.

162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave te references:

Specifikimet teknike jane hartuar nga struktura te specializuara/ Grup pune per objektin qe prokurohet, i ngritur me Urdher te Titullarit per hartimin e specifikimeve teknike/ termave te referencave, ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 41, pika 1, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kerkese funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard te kerkuar, ku çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike te ketij shërbimi, jane hartuar ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2 te VKM nr. 285, date

19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” (i ndryshuar), me qellim permbushjen e objektivave te kontrates, qellimit dhe rezultateve qe pritet te arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE te marre masat ne kohen e duhur qe te garantoje kapacitetet per permbushjen me sukses te kontrates sipas kushteve te percaktuara.

NJËSIA E PROKURIMIT